



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

---

Prishtinë, më 22 maj 2014  
Nr.ref.:RK627/14

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**Rastin Nr. KI180/13**

Parashtrues

**Radomir Nikolić**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. 125/2013, të 29 korrikut 2013**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u dorëzua nga z. Radomir Nikolić (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), me vendbanim të përkohshëm në Mlladenovc, Republika e Serbisë, të cilin në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës e përfaqëson, z. Gani Guraziu dhe avokati z. Ramiz Suka.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. 125/2013, të 29 korrikut 2013, i cili i është dorëzuar atij në shtator të vitit 2013.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. 125/2013, të 29 korrikut 2013, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur nenet 22 dhe 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 10 i Deklaratës Universale për të Drejta të Njeriut dhe neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-131 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

5. Më 23 tetor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 31 tetor 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin nr. GJR. KI180/13, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari me Vendimin nr. KSH. KI180/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 9 dhjetor 2013, Gjykata e informoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 19 dhjetor 2013, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë me pretendime të reja në lidhje me rastin.
9. Më 10 janar 2014, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë me pretendime të reja lidhur me rastin.
10. Më 30 janar 2014, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumente shtesë në formë të “aktit përcjellës” me pretendime të reja lidhur me rastin.
11. Më 11 shkurt 2014, Gjykata Kushtetuese, përmes një shkrese, kërkoi nga parashtruesi i kërkesës dhe përfaqësuesit e tij, që t’i saktësojnë pretendimet për shkeljet e të drejtave të parashtruesit të kërkesës.

12. Më 19 shkurt 2014, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi në Gjykatë pretendimet e saktësuara për shkeljet e të drejtave të parashtruesit të kërkesës.
13. Më 27 mars 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues Ivan Čukalović, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani, i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

14. Më 9 nëntor 1998, ishte lidhur kontrata 01 nr. 361-1507 për shitblerje të lokalit afarist, nr. 1/B-3, në sipërfaqe prej 19.90 m<sup>2</sup>, në katin përdhes, si dhe sipërfaqen prej 13.90 m<sup>2</sup> në nënkulm, në Qendrën Zejtare në Suharekë, në mes të Komunës së Suharekës, të cilën e ka përfaqësuar kryetari Stanimir Radić, në njërin anë dhe Radomir Nikolić, në anën tjetër. Kontrata është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Suharekë, me numër Vr. nr. 2132/98, të 29 dhjetorit 1998.
15. Në një datë të pacaktuar të vitit 2004, avokati publik komunal nga Suhareka, paraqiti padi kundër të paditurit Radomir Nikolić, të cilin sipas autorizimit e përfaqësoi avokati Ruzhdi Gashi, nga Suhareka, për shkëputjen e kontratës për shitblerjen e lokalit afarist në Qendrën Zejtare në Suharekë, për shkak se i padituri në llogari të paditëses 48502-630-042, në emër të buxhetit të Komunës së Suharekës, nuk i ka paguar këstet sipas kontratës për muajt: janar, shkurt, mars, prill, maj e përfundimisht më 7 qershor 1999.
16. Avokati publik komunal nga Suhareka, në padi propozoi që kontrata e shitblerjes së lokalit afarist të lartcekur të shkëputet për shkak të mospërmbushjes së obligimeve të parapara me kontratë.
17. Më 28 tetor 2005, Radomir Nikolić, si shitës, e lidh kontratën për shitjen e paluajtshmërisë kontestuese, e cila nuk është e vërtetuar në Gjykatë, me Gani Guraziun (në procedurën në Gjykatën Kushtetuese përfaqësues i Radomir Nikolićit) si blerës, me shënim në kontratë se ekziston masa e përkohshme në Gjykatën Komunale në Suharekë lidhur me të drejtën e pronësisë.
18. Më 7 korrik 2010, Gjykata Komunale në Suharekë, me Aktgjykimin C. nr. 03/04, e aprovon padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar dhe e shkëput kontratën 01 nr. 361-1507, të 9 nëntorit 1998, të lidhur në mes të Komunës së Suharekës në një anë dhe Radomir Nikolićit në anën tjetër, të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Suharekë, me numër Vr. nr. 2132/98, të 29 dhjetorit 1998, për shkak të mospërmbushjes së kontratës, sipas nenit 3 të kontratës së lartpërmendur, me arsyetimin se:

*“I padituri nuk i ka kryer obligimet e veta, siç janë paraparë me kontratë në nenin 3 të kësaj kontrate që shuma e përgjithshme të paguhet në 12 këste të barabarta. I njëjti nuk ka paguar asnjë këst për obligimin që ka pasur, sipas nenit 3 të kontratës mbi shitblerjen e lokaleve afariste. Paditësi me padi kërkon shkëputjen e kontratës për shkak të mospërmbushjes së saj, konform nenit 124 të LMD-së, i cili është në fuqi sipas dekretit të UNMIK-ut.*”

*Kur përmbushja e detyrimit në afatin e caktuar është pjesë përbërëse, esenciale e kontratës, ndërsa debitori nuk e përmbush detyrimin brenda këtij afati, kontrata zgjidhet me vetë të drejtën (neni 125, al 1 LMD). Në nenin 3 të kontratës mbi shitblerjen e lokalit afarist, në pikën 3, parashihet se mospagesa e tri kësteve, një pas një, tërheq të drejtën e shitësit për shkëputjen e kontratës”.*

*“Tezën e të autorizuarit të paditurit, avokatit Ruzhdi Gashi nga Suhareka, se i padituri në mënyrë legale i ka blerë lokalet afariste, dhe se kontratën e ka të vërtetuar në gjykatë, obligimet sipas kontratës i ka kryer në tërësi ndaj paditëses, shkresa që ka ofruar paditësi është e paqëndrueshme dhe e njëanshme, si dhe kërkesëpadia e paditësit është parashkruar, Gjykata i vlerësoi gjithanshëm, por si të tillë e refuzoi si të pa bazë, sepse i autorizuari i paditësit, Gjykatës i ofroi prova për mospagesën e obligimit të të paditurit ndaj paditëses, ndërkaq i autorizuari i të paditurit nuk i ofroi gjykatës prova kundër kërkesës së padisë, dhe në anën tjetër, padia dhe kërkesëpadia e padisë së paditësit nuk është parashkruar (neni 373 i LMD-së)”.*

19. Duke vendosur për ankesën e përfaqësuesit të të paditurit, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Suharekë, C. nr. 03/04, të 7 korrikut 2010, Gjykata e Qarkut në Prizren, me Aktgjykimin Ac. nr. 627/2010, të 25 shtatorit 2012, refuzon ankesën e përfaqësuesit të të paditurit, si të pabazuar, ndërsa vërteton Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Suharekë, C. nr. 03/04, të 7 korrikut 2010.

20. Duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurit, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 627/2010, të 25 shtatorit 2012, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin Rev. nr. 125/2013, të 29 korrikut 2013, hedhë si të paafatshëm revizionin e të paditurit, paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 627/2010, të 29 shtatorit 2012, me arsyetimin se:

*“Nga shkresat e lëndës rezulton se i autorizuari i të paditurit, avokati Ruzhdi Gashi, nga Suhareka, aktgjykimin e shkallës së dytë Ac. nr. 627/2010, të 25.09.2012, e ka pranuar më 20.12.2012, çka vërtetohet nga fletëkthesa në shkresat e lëndës, ndërsa revizionin kundër aktgjykimit të shkallës së dytë e ka dorëzuar në gjykatë më 04.02.2013, e autorizuar e të paditurit Aida Bilibani, gjë që qartë shihet se është paraqitur pas afatit të përcaktuar ligjor”.*

### **Pretendimet e parashtruesit**

21. Parashtruesi i kërkesës, në kërkesën e dorëzuar, arsyeton në mënyrë të detajuar një varg të shkeljeve, të cilat konsideron se i janë bërë gjatë procedurës në gjykatat e rregullta dhe pretendon si më poshtë se “vendimet e kontestuara, që janë marrë nga gjykatat gjegjëse, kanë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe me akte ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejtë në Kosovë, bazuar në nenin 22 të Kushtetutës. Rrjedhimisht, vendimet e kontestuara sa i përket kushtetutshmërisë së tyre, janë të paqëndrueshme, ngase: i) janë marrë nga organi (gjykata) që nuk ka pasur juridiksion për të

marrë të tilla vendime; ii) Paraqitësit të Kërkesës nuk i është dhënë mundësia të marrë pjesë në trajtimin e çështjes në shqyrtim kryesor; iii) Gjykata ka tejkaluar kërkesëpadinë e palës Paditëse; iv) Gjykata ka dështuar të trajtoj çështjet e ngritura nga Paraqitësi i Kërkesës etj. Këto dhe shkelje të tjera kanë rezultuar me shkeljen e Nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, gjegjësisht të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar, po ashtu, edhe me Nenin 10 të Deklaratës së Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut, dhe Nenit 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokolleve të saj”.

22. Në bazë të pretendimeve të arsyetuara në mënyrë të detajuar në këtë kërkesë, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që:

- *“Kërkesën e paraqitësve të kërkesës ta konstatojë të pranueshme;*
- *Në përputhje me rregullin 39 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore; dhe*
- *Të konstatojë cenimin e të drejtave individuale të Paraqitësit të kërkesës z. Radomir Nikolić, të garantuara me Nenet 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Nenin 10 të Deklaratës së Përgjithshme Për të Drejtat e Njeriut, dhe Nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokolleve të saj;*
- *Të caktojë çfarëdo shkelje tjetër të të drejtave të Paraqitësit të kërkesës që kjo gjykatë i konstaton gjatë shqyrtimit të çështjes”.*

### **Pranueshmëria e kërkesës**

23. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, duhet së pari të shqyrtojë nëse ai i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore.

24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113. 7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

25. Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

26. Për më tepër, Gjykata thirret në rregullin 36 (2) b) të Rregullores, i cili parasheh:



„(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

...

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese“.

27. Duke i shqyrtuar pretendimet e parashtruesit, në lidhje me pretendimin se vendimet: “i) janë marrë nga organi (gjykata) që nuk ka pasur juridiksion për të marrë të tilla vendime”; si dhe pretendimi se” ii) Paraqitësit të kërkesës nuk i është dhënë mundësia të marrë pjesë në trajtimin e çështjes në shqyrtim kryesor” në arsyetimin e shkeljeve nga parashtruesi, Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është gjykatë e apelit, kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I). Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 627/2010 i 25 shtatorit 2012, dhe Aktvendimi i Gjykatës Supreme në Prishtinë Rev. nr. 125/2013, i 29 korrikut 2013, në arsyetimet e tyre në mënyrë të detajuar shpjegojnë dhe japin përgjigje në këto pretendime të parashtruesit.
28. Duke i shqyrtuar pretendimet e parashtruesit, në lidhje me pretendimin se “iii) Gjykata ka tejkaluar kërkesëpadinë e palës Paditëse” si dhe pretendimin se “iv) Gjykata ka dështuar të trajtoj çështjet e ngritura nga Paraqitësi i kërkesës”, në arsyetimin e shkeljeve nga parashtruesi, Gjykata Kushtetuese thekson se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (shih, *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, të 31 majit 2005), për më tepër, vetë parashtruesi në kërkesën e 10 janarit 2014, pretendon se “debitori Radomir Nikolić (tani parashtrues i kërkesës) nuk ka pasur mundësi ta përmbushë kontratën, për shkak të rrethanave, për të cilat ai nuk është përgjegjës”. Kjo gjë të çon në përfundimin se paditësi nuk ka mundur të bëhet pronar i lokalit në fjalë.
29. Në të njëjtën kohë, parashtruesi, në kërkesën fillestare të dorëzuar më 23 tetor 2013, pretendon se “Përfaqësuesi i përkohshëm nuk ka veprue sipas autorizimit (Aktvendimit) mbi caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm dhe me qëllim ka lëshuar mjetin juridik të jashtëzakonshëm-Revizionin dhe me këtë Radomir Nikolić nuk është njoftue, dhe as e autorizuar e tij Aida nuk është njoftuar dhe me këtë është shkelë e drejta e qytetarit në gjykim të drejtë neni 3 i Kushtetutës së Kosovës”.
30. Përderisa në dokumentet shtesë, të dorëzuar më 19 dhjetor 2013, ai theksoi të kundërtën “që përfaqësuesja Aida me kohë ka ushtruar revizion e ka pranuar me dt. 20.12.2012, çka është vërtetue nga fletëkthesa në shkresa të lëndës”. Ndërsa Gjykata Supreme ka gabuar “Gjatë llogaritjes së afateve është llogaritur se që nga dt 20. 12.2012 e deri më dt 04.02.2013 duke i zbritur festat fetare e zyrtare si dhe ditët jo të punës e shtune dhe e dielë janë gjithsej 28 ditë e 12 orë , çka do të thotë se revizioni ka qenë i afatshëm dhe as që është llogaritur me kujdes nga Gjykata Supreme”.

31. Në këtë rast, parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta që të paraqesë rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e ligjit për të cilin konsideron se është i pasaktë, para Gjykatës Komunale në Suharekë, Gjykatës së Qarkut në Prizren dhe Gjykatës Supreme në Kosovë. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka vërtetuar se procedurat relevante, në çfarëdo mënyre, kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituaniës*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).
32. Përfundimisht, kushtet për pranueshmëri nuk janë plotësuar në këtë kërkesë. Parashtruesi nuk ka treguar dhe mbështetur me prova se me aktvendimin e kontestuar pretendohet t'i jenë shkelur të drejtat dhe liritë e tij kushtetuese.
33. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (2) b) të Rregullores.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës, më 27 mars 2014, njëzëri


### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović



Prof. dr. Enver Hasani

